



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1317/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Mitrovicë, paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit në Shkollën Filllore "Harun Beka" në fshatin Gushavc të Mitrovicës, për shkak të përshkrimit të votave për subjektin tjetër politik, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 24.12.2013, nga subjekti politik PDK dega në Mitrovicë, me të cilën pretendohet se në vendvotimin 1114B/01R ka pasur shkelje ligjore ku 148 votat e PDK-së i janë shënuar subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS)

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuar pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë për ti vërtetuar pretendimet e parashtruara në ankesë.

Meqenëse parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që me asnjë provë ti vërteton pretendimet e parashtruara në ankesë PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1317/2013 më datën 27.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.